

AKT THEMELTAR  
I SHOQËRISË "A & Y" SH.P.K. Tiranë

Sot në Tiranë në datën 12 Mars 1998 Ortaku i Vetëm Arjan Pelushi i biri i Hates dhe i Zyresë, i datëlindjes 9.2.1962, lindur në Tiranë dhe banues në Rrugën Konferenca e Pezës Nr-170/1 Tiranë, shtetas Shqiptar, me arsim të Lartë, madhor dhe me aftësi të plotë për të vepruar, Pasap.Nr0960841., me vullnetin e tij të lirë në bazë të ligjës Nr 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare" dhe ligjës Nr 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregëtar dhe Formalitetet që duhen të respektohen nga Shoqëritë Tregëtare" vendosi të përpilojë këtë Akt Themelimi për themelimin e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar si më poshtë:

Neni 1

Themelohet Shoqëria Prodhuese me material të porositësit dhe Tregëtare me përgjegjësi të kufizuar "A & Y" Sh.p.k Tiranë.

Neni 2

Selia e Shoqërisë do të jetë në Rrugën Konferenca e Pezës Nr 170/1 Tiranë

Neni 3

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje mbi dhjetë vjet. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Ortakut të Vetëm themelues dhe mund të shkurtohet në ato raste që do të përcaktohen në statut, i cili pas Akt Themelimit është dokumenti më themelor i shoqërisë.

Neni 4

OBJEKTI I SHOQËRISË do të jetë:

- Përpunimi i parë dhe i dytë i llojeve të ndryshme të lëndës drusore me material të porositësit.
- Import Eksport me shumicë dhe pakicë i produkteve drusore, plastike dhe materialeve të ndryshme gjysëm të përpunuara.
- Import Eksport paisje, makineri e aksesori të ndryshëm për përpunimin e drurit dhe materjaleve plastike për prodhime gjysëm të gatëshme, për orëndi, mobilie, korniza, paisje kopshti si dhe për ambiente të brëndëshme e të jashtëme të vilave e shtëpive.
- Veprimtari tregëtare brënda dhe jashtë vendit, me shumicë e pakicë në të gjitha sferat si: materiale ndërtimi, makineri, mallra industriale, hidro-sanitare, elektro shtëpiake, etj.

Neni 5

Kapitali Themeltar i Shoqërisë do të jetë 100.000 lekë (njëqindmijë) i depozituar në një bankë në Tiranë.

Neni 6

Kapitali i Shoqërisë është plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkruar nga Ortaku i Vetëm, si dhe i transferueshëm lirisht brenda e jashtë shtetit në rrugë ligjore, familjare, trashëgimie, pjesëtim pasurie, shlyerje llogarish me të tretët, etj.

Neni 7

Ortaku i Vetëm Organet Drejtuese  
Administratori i Shoqërisë do të jetë zonja Anila Pelushi  
Asambleja e Shoqërisë

Neni 8

Shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë dhe punonjës me kontratë pune me shkrim duke zbatuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligja "Mbi Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë"



Neni 9  
Shoqëria do të shërbëhet në atë raste që shprehimisht përcaktohet në Statutin e saj ose në ligjë.

Neni 10  
Shoqëria ka të drejtë të çelë degë e filiale të saja brenda ose jashtë vendit në bazë të Vendimit të Ortakut të Vetëm dhe konformë legjislativnit shqiptar në fuqi.

Neni 11  
Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë do të fillojnë me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Viti Financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim kur Ortaku i Vetëm do të vendosë ndryshe.

Neni 12  
Ky Akt-Themelimi u përpilua në disa kopje të barabarta, të nënshkruara në çdo fletë nga Ortaku i Vetëm, me qëllim që tju jepet organeve kompetente, dhe njera prej të cilave do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë së bashku me statutin e saj.

Tiranë 12.03.1998

Ortaku I Vetëm  
Arjan Pelushi  
*Arjan Pelushi*  
*AP*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
NOTERIA TIRANË  
Nr 1277 Rep.  
Nr 517 Kol.

V È R T E T I M

Sot në datën 16-03-1998 në zyrën e Notere këtu në Tiranë, u paraqit para meje Zoti Arjan Pelushi, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta me Nr 0960841, i cili para meje deklaroi se ky Akt-Themelimi i shoqërisë "A & Y" shpk është përpiluar dhe firmosur me vullnetin e tij të lirë plotësisht, dhe unë Notere e vërtetoj atë me cilesinë që më jep ligja.

ranë \_\_\_\_\_ 1998

NOTER



S T A T U T I  
I SHOQËRISË " A & Y " SH.P.K. TIRANË

Në Tiranë, sot në datën 12 Mars 1998, Ortaku i Vetëm themelues i Shoqërisë "A & A" Shpk, në bazë të ligjës 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregëtare dhe ligjës 7667 datë 28.1.1993 "Për Regjistrin Tregëtar dhe Formalitete që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare" si dhe duke u mbështetur në Akt Themelimin e Shoqërisë "A&A" shpk miraton këtë statut bazë për karakterin dhe veprimtarinë e shoqërisë.

Neni 1

Forma dhe Emërtimi

Shoqëria e themeluar është një shoqëri përpunuese me material të porositësit dhe tregëtare me përgjegjësi të kufizuar dhe e emërtuar "A & A" shpk

Neni 2

Kohëzgjatja

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje mbi 10 vjet. Ky afat mund të zgjatet me vendim të Ortakut të Vetëm themelues dhe mund të shkurtohet në ato raste që do të përcaktohen në statut.

Neni 3

Selija e Shoqërisë

Selija e shoqërisë do të jetë në Rrugën Konferenca e Pezës Nr 170/Tiranë

Neni 4

Objekti i Shoqërisë

Objekt i aktivitetit të shoqërisë do të jetë:

- Përpunimi i parë dhe i dytë i lëndës drusore me material të porositësit.
- Import Eksport me shumicë dhe pakicë i produkteve drusore, plastike dhe materialeve të ndryshme gjysëm të përgatitura apo të përpunuara.
- Import Eksport paisje, makineri e aksesore të ndryshëm për përpunimin e drurit dhe materialeve plastike për prodhime gjysëm të gatëshme, për orëndi, mobilie, korniza, paisje kopshji si dhe për ambiente të brëndëshme dhe të jashtëme të vilave dhe shtëpive.
- Veprimtari tregëtare brënda dhe jashtë vendit me shumicë dhe pakicë në të gjitha sferat, si industriale, materiale ndërtimi, makineri, mallra elektro-shtëpiake, hidrosanitare, etj.

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar do të jetë 100.000 lekë (njëqindmijë), i depozituar në degën e Bankës \_\_\_\_\_ Tiranë.

Neni 6

Fitimet e shoqërisë i përkasin vetëm Ortakut të Vetëm.

Neni 7

Kapitali i shoqërisë është plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga Ortaku i Vetëm, gjithashtu ky kapital është lirisht i transferueshëm brenda dhe jashtë vendit në rrugë ligjore, familjare, trashëgimore, pjestim pasurie, shlyerje llogarish me të tretët, etj.

Neni 8

Organet Drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Ortaku i Vetëm.

-Administratori i Shoqërisë: ë cila do të jetë zonja Anila Pelushi.  
-Asambleja e Shoqërisë.

Neni 9

Ortaku i Vetëm përveç sa citohet në Akt-Themelimin dhe dispozita të tjera të këtij statuti, ka të drejtë: - të emëroje dhe të shkarkojë Administratorin të mbledhë asamblenë një herë në çdo gjashtë muaj apo sipas nevojës, të shtojë apo të pakësojë kapitalin themelor të shoqërisë, të bëjë ndryshime ose shtesa në statut, të miratojë bilancin vjetor dhe fonde të veçanta financimi, zgjzimin ose kufizimin e veprimtarisë së shoqërisë, pjesëmarrjet e shoqërisë në aktivitete të përbashkëta ekonomike me të tretët ose me shoqëri të tjera qofshin këto të vendit apo të huaja, të mbratojë kalimin e shoqërisë në procesin e likuidimit, të miratojë shndrimin e saj në shoqëri tjetër kolektive, shpërbërjen apo çregjistrimin e shoqërisë.

Neni 10

Administratori dhe këshilli i tij konsultativ zgjidhen çdo vit. Administratori përfaqson juridikisht shoqërinë në tërë veprimtarinë e saj fiskale dhe juridiko-civile, në organet shtetërore dhe në organizmat e ndryshme të vendit sipas kriterëve të përcaktuara ligjore, në mungesë të Ortakut të Vetëm dhe me autorizim të tij.

Me prokurë me shkrim të Ortakut të Vetëm, shoqërinë mund ta përfaqësojë çdo person tjetër.

Neni 11

Administratori harton raportin e administrimit, inventarin dhe llogaritë vjetore. Administratori miraton tek Ortaku i Vetëm llogaritë sipas raportit të ekspertëve kontabël. Vetëm Ortaku i Vetëm mund të miratojë llogaritë në se është e nevojshme brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 12

Administratori i propozon Ortakut të Vetëm për të punësuar specialistë dhe punonjës. Ai organizon drejtimin e tërë veprimtarisë ekonomiko-operative, merr masat për të siguruar efektivitetin ekonomik në tërësi dhe nga çdo i punësuar në veçanti.

Neni 13

Administratori me miratimin e Ortakut të Vetëm ka të drejtë veprimtarinë e degëve dhe pikave të shitjes, të caktojë rregulloret për çdo vend pune, të emërojë dhe të shkarkojë specialistët dhe punonjësit në bazë të kontraktave të punës dhe të respektojë sipas ligjës kërkesat kontraktore.

Neni 14

Asambleja e Shoqërisë përbëhet nga Ortaku i Vetëm, Administratori, Përgjegjësit e degëve të përpunimit dhe të shitjes, si dhe nga specialiste të shoqërisë. Asambleja mbledhet jo më pak se dy herë në vit, ajo shqyrton dhe diskuton programin dhe detyrat e vëna nga Ortaku i Vetëm, miraton planin e punës, propozon masa të reja për zhvillimin ekonomiko-financiar. Propozimet dhe masat që parashikon asambleja për mbarëvajtjen e punëve i paraqiten Ortakut të Vetëm i cili duhet të shprehet për miratimin e tyre brenda një muaji.

Neni 15

Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria fiton zotësinë e saj për të vepruar në bazë të këtij statuti dhe menjëherë pas regjistrimit si Person Juridik në Regjistrin Tregëtar në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Do të vlerësohen veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime juridike të kryera nga Ortaku i Vetëm, Administratori dhe punonjësit e saj të kryera

*Arby*

konformë disponimeve të këtij statuti dhe në bazë të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Për derisa shoqëria të krijojë fizinomin e saj, për të gjithë veprimtarinë do të përgjigjet Ortaku i Vetëm zoti Arjan Pelushi.

#### Neni 16

Për detyrimet e lindura pas themelimit të shoqërisë do të përgjigjet vetë shoqëria me kapitalin e saj.

#### Neni 17

Njetet e investuara për themelimin e shoqërisë si dhe ato që do të fitohen apo shtohen gjatë aktivitetit të saj ekonomik, regjistrohen menjëherë në Librin Afarist të Shoqërisë. Ortaku i Vetëm mund ti delegojë kompetencat e tij. Vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm, Administratori dhe Asambleja e shoqërisë evidencohen në një rregjistrë.

Vendimet e marra në kundërshtim me përmbajtjen e këtij neni mund të anulohen me kërkesën e çdo personi të interesuar.

#### Neni 18

##### Punësimi në Shoqëri

Për realizimin e aktivitetit të saj në rritje shoqëria ka të drejtë të punësojë specialistë dhe punonjes të ndryshëm me kontratë punësimi me shkrim me ose pa afat të përcaktuar (sipas kontratës tip) duke respektuar kriteret e Kodit të Punës dhe të Sigurimeve Shoqërore e të Sindikatave.

#### Neni 19

I punësuar nuk merr pjesë në fitimet apo humbjet e shoqërisë, por ai përgjigjet materialisht ndaj saj për dëmin ekonomik që mund ti shkaktojë me dashje apo nga pakujdesia në detyrë shoqërisë.

#### Neni 20

##### Eksperti Kontabël

Kur e kërkon ligji ose në çdo rast tjetër nevojë që kryhet kontroll tërësor apo pjesor i aktivitetit të shoqërisë, për një periudhë kohe të caktuar sipas rastit nga organi kompetent shtetëror, ose Ortaku i Vetëm, ky kontroll kryhet nga një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar nga Ortaku i Vetëm.

#### Neni 20

##### Viti Financiar. Bilanci.

Viti financiar fillon në 1 janar dhe mbaron në 31 dhjator të çdo viti. (viti i parë financiar fillon nga dita e regjistrimit në gjykatën e rrethit Tiranë) Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar si dhe raportet e veçanta të hartuara nga Ortaku i Vetëm apo Administratori dhe eksperti kontabël, miratohen dhe evidentohen në regjistrë.

#### Neni 21

##### Dividentët

Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe të evidentimit të fitimeve, shlyen detyrimet pasurore të shoqërisë, detyrimet kontraktore me të tretët, bëhet pagesa e taksave dhe tatimeve, sigurimeve shoqërore, dhe vetëm më pas Ortaku i vetëm merr vendim për përdorimin e fitimit të shoqërisë. Asambleja bën propozimet e veta mbi përdorimin e fondeve që i vihen në dispozicion për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit.

#### Neni 22

##### Shpërbërja e Shoqërisë

Shoqëria mund të shpërbëhet në këto raste:

- Me vendim të Ortakut të Vetëm kur për dy vjet radhazi nuk është rentabël
- Me plotësimin e afatit të kohëzgjatjes së saj.

- Në rast falimentimi ekonomik.
- Në rast se shprehimisht do të citohet në ligjë.
- Në rast se Ortaku i Vetëm Vdes.
- Shoqëria nuk shpërbëhet në rast se Ortaku i Vetëm bëhet i paafte ose i hiqet e drejta nga organet tatimore për të ushtruar veprimtarinë e tij në Shoqëri.

Neni 23

Likujdimi i Shoqërisë

Shoqëria hyn në procesin e likujdimit qysh në momentin e shpërbërjes. Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale dhe etyre ndaj të tretëve, likujduesi ndan kapitalet e mbetura që i takon Ortakut të Vetëm.

Neni 24

Dispozita të Përgjithëshme

Shoqëria ka vulën e saj me këtë përmbajtje:

" A & Y " Sh.p.k  
Tiranë Albania

Neni 25

Mosmarrëveshjet juridiko civile të lindura ndërmjet shoqërisë dhe personave të tretë, në rastet që nuk do të zgjidhen me hirëkuptim nga Ortaku i Vetëm, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

Neni 26

Ky statut u përpilua në disa kopje të barabarta për tu paraqitur në organet kompetente dhe i nënshkruar në çdo fletë nga Ortaku i Vetëm një kopje do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë së bashku me Akt-Themelimin.

Tiranë 12.03.1998

Ortaku i Vetëm  
Arjan Pelushi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
NOTERIA TIRANË

Nr 1570 Rep.  
Nr 306 Kol.

V E R T E T I M

Sot në datën 16-3 1998 në zyrën e Noterisë, u paraqit para meje zoti Arjan Pelushi, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova nga Pasaporta me Nr-0960841, i cili para meje deklaroi se ky statut i shoqërisë " A & Y " Shpk është përpiluar dhe është firmosur me vullnetin e tij në plotë, dhe unë, Notere \_\_\_\_\_ e vërtetoj me cilësinë që më jep ligja.

Tiranë \_\_\_\_\_ 1998

NOTER

